

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/11/qeveria-jep-90-mije-m2-me-1-euro-per-investimin-strategjik-ne-gjirin-e-lalezit/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 14:58:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 14:53:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d5bd9d93c222e3c893f4da1535103522bcb48b8d2d7c21cff3a895737edc3f3f
TEKSTI	7afc31bd7b0de429c8bf01d95aac24dcd9e05d48d3aa7405c1f34cf48c8806d5
PAMJA	b502b3d9b324f7a1960fe7cf1122c369d710c36065863ab0a913a4ab45ab6590

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	01b860e4de8b063648bac7db8048072b803abee47a819c2922b9985a39c998b5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	449e01d01289e86e32f44a76b2516514aa0ab1525100d1a30f454146706caeb7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/01b860e4de8b063648bac7db8048072b803abee47a819c2922b9985a39c998b5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Lajme

Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit

Këshilli i Ministrave miratoi të premten kalimin e mbi 90 mijë metrave katrorë tokë shtetërore me tarifën simbolike 1 euro në funksion të një investimi strategjik në Gjirin e Lalëzit.

nga Blerina Gjoka — 15 seconds më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Gjiri i Lalëzit. Foto: Facebook.

Vendimi parashikon "vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.178/44, nr.152/43 dhe nr.182, në zonën kadastrale 1522, Bashkia Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 90 030 m², në pronësi shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në favor të shoqërisë 'OMNIX ALBANIA'".

Sipas vendimit që i jep statusin investitor strategjik, kompania synon të zhvillojë në Gjirin e Lalëzit një kompleks turistik me hotel me pesë yje, park ujqor, ambiente rezidenciale, klub plazhi dhe struktura të tjera turistike. Projekti parashikon një investim prej 216 milionë eurosh dhe hapjen e 252 vendeve të punës.

Investimi i "Omnix Albania" në Gjirin e Lalëzit ka nisur që një dekadë më parë, kur kompania kontrollohej nga biznesmeni nga Katari Jamal Abdulsalam M. Abuissa, themelues i grupit Omnix me administrator dhe përfaqësues të kompanisë biznesmenin libanez, Fadi Mitri.

Në vitin 2016, Mitri u dhunua rëndë në prani të bashkëshortes dhe vajzës së tij dhe pas ngjarjes, u largua nga Shqipëria dhe projekti mbeti për vite i parealizuar në formën e parashikuar fillimisht.

Në vitet pasuese, struktura e pronësisë nisi të ndryshojë dhe kapitali i kompanisë kaloi gradualisht te shoqëri shqiptare. Aktualisht ajo zotërohet nga kompania "Klar" në 50% të aksioneve në pronësi të Shkëlqim Beshirit, kompanitë "Matrix Konstruksion" dhe "Blessed Investment" të vëllezërve Arian dhe Besnik Leskaj me nga 17.5% secila dhe "RDA Petrol" në pronësinë e ish-deputetit Fation Veizaj me 15%.

Praktika e dhënies së tokave shtetërore me tarifën simbolike 1 euro është një praktikë e zakonshme e qeverisë "Rama" kryesisht për tokat në bregdet me synim mbështetjen e zhvillimit të turizmit.

Përveç tokës publike falas, investorët strategjikë kanë përfutur edhe lehtësira të tjera shtetërore si akses të shpejtë në procedura, marrjen afatgjatë të vijës bregdetare në përdorim, konsolidim të tokës apo investime me para publike.

Etiketa: Edi Rama Gjiri i Lalëzit Investim strategjik Omnix Albania Tokë publike

Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit

16:53 | 11/09/2026

Gjykata urdhëron Ministrinë e Financave që të zhbllokojë pagat e GJKKO

13:51 | 11/09/2026

Rama shkarkon ministrin e Brendshëm pa motivacion publik

11:43 | 11/09/2026

Një vilë në këmbim të tenderit, SPAK: Si e fshehu Balluku pronën e dytë në Palasë

06:57 | 11/09/2026

Prokurorët e Hagës kërkojnë gjashtë vjet burg për Thaçin për pengim të drejtësisë

16:00 | 10/09/2026

SPAK zbulon 11 të dyshuar të tjerë në skemën e mashtrimit me 'call center'

15:08 | 10/09/2026

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakttoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Slida.PRO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.